

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 E enjte, 23 shtator 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 11.31

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi. Mirë se erdhët.

7 Zonja Sekretare, ju lutem thërrisni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
9 Gjykatës, kjo është çështja Prokurori i Specializuar kundër
10 Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit, zonja Sekretare.

13 Tani do t'i kërkoja që të prezantoheshin, duke filluar
14 pikë së pari nga Prokuroria. Zoti Prokuror, mund të filloni.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
16 Gjykatës, mirëmëngjes të gjithëve, Prokuroria sot prezantohet
17 nga unë, Cezary Michalczuk, me mua sot këtu është, Silvia
18 D'Ascoli, në të majtën time, që është ndihmësprokurore e
19 Prokurorisë së Specializuar, Filippo de Minicis, ndërkohë që
20 Julie Mann është menaxherja e çështjes për ditën e sotme.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, zoti prokuror.

23 Mbrojtësja e Viktimave?

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar, mirëmëngjes. Mirëmëngjes
25 të pranishmëve të tërë. Skuadra ime përfaqësohet sot nga unë,

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Annie Pues dhe Mari-Pier Barbeau, që është mbështetja e grupit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mbrojtja.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve. Mbrojtja
5 përfaqësohet nga unë, Julius Von Bone dhe Betim Shala që është
6 bashkëpunëtori im, ndërkohë që kemi edhe hetuesin, zotin Fatmir
7 Pelaj. Të pranishëm në sallën e gjyqit është gjithashtu edhe
8 Zoti Mustafa.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit.

11 Zoti Mustafa, kujtoj që keni të drejtën të qëndroni në
12 heshtje dhe heshtja nuk do të merret parasysh për përcaktimin e
13 fajësisë dhe pafajësisë tuaj.

14 Tani i kthehem Zyrës së Administrimit.

15 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar, unë jam
16 Ralph Roche nga Zyra e Administrimit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
18 procesverbal, kolegët e mi janë Gjykatësi Rolad Dekkers,
19 Gjykatësi Gilbert Bitti, Gjykatësi Vladimir Mikula, Gjykatës
20 rezervë, ndërkohë që unë jam Mappie Veldt-Foglia, Kryegjykatëse
21 e Trupit Gjykues Nr. 1.

22 Duket sikur ka një problem me transkriptimin. Mu kërkua që
23 të jap një moment kohë për teknicienët në mënyrë që të shohim
24 nëse ky problem mund të zgjidhet kështu që do të presim për pak
25 minuta.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Më thanë që mund të -- pesë deri në dhjetë minuta sepse
2 duhet që të rinisim sistemin, kështu që do presim disa minuta
3 deri sa të rifillojë sistemi sërish, deri në atë moment,
4 ndërpritet seanca.

5 --- Pauza fillon në orën 11.36

6 --- Seanca rifillon në orën 11.41

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
8 lutem uluni. Do të rifillojmë seancën.

9 Zonja Sekretare, a mund të fillojmë?

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, po
11 konfirmojmë thjesht me kolegët. Po, jemi në rregull. Mund të
12 fillojmë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
14 faleminderit, zonja Sekretare. Mirëmëngjesi dhe mirë se keni
15 ardhur. Zonja Sekretare, ju lutem a mund të thërrisni lëndën?

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi të nderuar.
17 Kjo është çështja e Prokurorit të Specializuar kundër Salih
18 Mustafës, çështja KSC-BC-2020-05.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit, zonja sekretare.

21 Tani do të doja që t'i kërkoja palëve që të
22 prezantoheshin, duke filluar me Zyrën e Prokurorisë së
23 Specializuar.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar,
25 Prokuroria sot përfaqësohet nga unë, Cezary Michalczuk,

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 prokuror i ZPS-së, Silvia D'Ascoli, ndihmësprokurore nga ZPS-
2 ja, Filippo de Minicis, një tjetër zëvendësprokuror i
3 Prokurorisë së Specializuar dhe Julie Mann që është menaxherja
4 e çështjes. Faleminderit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Mbrojtësja për Viktimat, e keni ju fjalën.

7 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit. Ne përfaqësohemi nga
8 Annie Pues dhe Marie-Pier Barbeau, zyrtare e lartë, juriste e
9 lartë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Mbrojtja për të Akuzuarit, fjala për juve.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Përshëndetje. Skuadra ime
13 përfaqësohet nga unë, zoti Von Bone, ndërkohë që kemi edhe
14 zotin Shala, i cili është bashkëpunëtori im dhe kemi edhe
15 hetuesin, zotin Fatmir Pelaj. Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
17 Mustafa, ju kujtoj që keni të drejtën që të mbani heshtjen dhe
18 që heshtja nuk është -- merret parasysh për deklarimin e
19 fajësisë apo pafajësisë tuaj.

20 Zyrës së Administrimit.

21 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse,
22 unë jam Ralph Roche nga Zyra e Administrimit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
24 procesverbal, Trupi Gjykses përbëhet nga gjykatësi Rolad
25 Dekkers, Gjykatësi Gilbert Bitti, Gjykatësi Vladimir Mikula, që

1 është Gjykatës rezervë dhe unë Mappie Veldt-Foglia,

2 Kryegjykatëse e Trupit Gjykues nr. 1.

3 Tani le të vijojmë me thirrjen, me dëshminë e Dëshmitarit
4 3593. Ju lutem zonja Sekretare, a mund të shoqëroni
5 dëshmitarin në sallën e gjyqit?

6 [Dëshmitari hyn në sallë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
8 Dëshmitar, mirë se erdhe dhe mirëmëngjes. A pushuat ndopak?

9 DËSHMITARI: Shumë mirë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
11 mirë, zoti Dëshmitar. Në pajtim me rregullin 127(3) të
12 Rregullores, Trupi Gjykues në çdo fazë mund t'ju bëj juve disa
13 pyetje. Juve ju bënë pyetje gjatë ditëve të mëparshme nga
14 Prokuroria, po ashtu ju bënë pyetje nga Mbrojtja e Viktimave
15 dhe Mbrojtja e të akuzuarit. Ndërkohë që sot do t'ju bëjnë disa
16 pyetje anëtarët e Trupit Gjykues.

17 Në këtë mënyrë ne shpresojmë që të qartësohemi pak më
18 tepër lidhur me gjërat që ju keni deklaruar si pjesë e dëshmisë
19 suaj dhe përgjigjet që do të jepni sot do të kenë vlerë të
20 madhe, në mënyrë që ne të kuptojmë pak më mirë se çfarë ka
21 ndodhur.

22 E kuptoj që ke katër ditë që je këtu me ne, e kuptoj që ka
23 qenë periudhë e gjatë, e vështirë për juve, e lodhshme, por ju
24 lutem duroni edhe pak dhe tani do të fillojmë me disa pyetje
25 për ju.

1 DËSHMITARI: W03593 [Vazhdimi]

2 Marrje në Pyetje nga Trupi Gjykses:

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pyetja
4 e parë. Do fillojmë në seancë me dyer të hapura dhe pastaj do
5 kalojmë në seancë me dyer të mbyllura.

6 Ushtarët a kishin maska në vendin, në Zllash, kur je mbajt
7 ti i ndaluar?

8 Pë. Jo.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po jua
10 bëj këtë pyetje sepse në një moment të caktuar përpara UNMIK-ut
11 në vitin [REDAKTUAR] juve thatë, edhe do tua jap përnjëherë
12 referencën e deklaratës që keni bërë, që kishte një person që
13 kishte vënë një maskë, që ja u vendosi revolverin, pistoletën.

14 Tani referenca për ju është SPOE00127751 deri në të
15 njëjtin numër dhe shifrat e fundit janë 69, në RED4 dhe faqja
16 specifike, është SPO00127752.

17 Të lutem, a na shpjegon dot se pse ke thënë atëherë, në
18 qoftë se e mban mend sigurisht, që kishte një person që kishte
19 vënë, kishte veshur maskë?

20 Pë. Nuk e mohoj, ndoshta e kom thonë, por apet po thom, nuk --
21 nuk besoj që ka pas maskë. S'kom mujt me i vrejt me pa, se
22 s'kom mujt me kqyr.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
24 Dëshmitar, e dëgjoj përgjigjen tënde por thjesht për ta kuptuar
25 unë, pra në një moment të caktuar kohe, ti ke thënë që personi

1 kishte vesh maskën. Dhe këtu unë jam duke u përpjekur të kuptoj
2 se pse në atë periudhë kohe ti ke thënë që personi e kishte
3 maskën ndërkohë që tani po thau që, "jo nuk mendoj që ky
4 personi ka pas të veshur maskën". Pra e kuptoj përgjigjen që
5 thua, që tani unë mendoj që ai nuk e ka pas maskën atëherë dhe
6 pyetja ime këtu është se pse e ke thënë ndryshe në vitin 2066
7 përpara UNMIK-ut.

8 Pë. Po kum harru, noshta kom thon. Veç i tash po them se po
9 mendoj se tash nuk po kam pa me maskë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E shoh
11 në deklaratën e dëshmitarit që ju keni dhënë me numër 061015-
12 TR-ET, Pjesa 2, E Rishikuar, faqja 5, rreshti 6, që prokurorit
13 të specializuar, kur jeni marrë në intervistë nga Prokuroria e
14 Specializuar , që fytyrat nuk i shin të mbuluara.

15 Por në qoftë se do të bëja një përmbledhje të asaj çfarë
16 thatë, ju po thoni që nuk e mbaj mend që pse e kam thënë këtë
17 gjë atëherë por tani po ju them që e mbaj mend që fytyrat e
18 tyre nuk është se ishin të mbuluara. A e thatë kështu? Është
19 përmbledhje e mirë kjo?

20 Pë. [E padëgjueshme].

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
22 tjetër pyetje është që në deklaratën tuaj gjatë ditëve të
23 fundit dhe referenca është transkriptimi, faqja 45, rreshti 22
24 dhe 23, ju thatë që pas një muaji, pasi u liruat kur ishin në
25 Zllash, se ti mësove se cili ishte emri i komandantit në vendin

1 ku ti mbaheshe.

2 Pë. Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në të
4 njëjtën deklaratë që përmenda pak më përpara që është me numrin
5 e referencës SPOE00127751 deri në 69RED4 dhe specifikisht në
6 127756, faqja 6 e deklaratës që keni dhënë, ti the te
7 deklaratata, pra the që në deklaratën e vitin [REDAKTUAR], jo një
8 muaj pasi u lirove, por disa muaj mbasi ka ndodhur kjo gjë, që
9 ti nuk dije se kush ishte mbikëqyrësi, kush ishte përgjegjësi
10 në atë kamp.

11 A mund të na e shpjegosh pak që -- pra do ta them edhe një
12 herë pyetjen time, por ajo çfarë thatë dje ose pardje, ti the
13 që "Pas një muaji e mësova se kush ishte personi përgjegjës
14 atje" ndërkohë që përpara UNMIK-ut ke thënë se nuk e dije se
15 kush ishte personi mbikëqyrës. A mund të na e shpjegosh pak
16 këtë gjë të lutem?

17 Pë. Po, mas një muaji e kam vërtetue se kush ishte ai personi
18 që a konë kryesor q'aty në q'atë kampin aty.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
20 por në vitin [REDAKTUAR] ti ke thënë "nuk e di, nuk e di se
21 kush ishte kryesori atje". Pra pyetja ime është pse nuk e ke
22 thënë atëherë ti emrin që ke dëgjuar, që ke mësuar një muaj
23 pasi u lirove nga aty ku ishe?

24 Pë. Vallahi ndoshta nuk kom thonë se jam konë nuk e di, a kom
25 harrue ça kom bo, po t'thom të drejtën, që dje m'non pyet ça

1 kom fol dhe nuk po e di çka, se m'kanë pyetur ka 200 herë, aty
2 ndoshta kom gabuar. Nuk e maj mend, por mas një muaji e kom mor
3 vesht personi kush ka qenë ai.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
5 Dëshmitar, në vitin [REDAKTUAR] ti ke thënë që nuk e dije se
6 kush ishte personi. A do të thotë kjo se ti nuk po thoshe çdo
7 gjë që dije rreth situatës në vitin [REDAKTUAR]? Sepse duket
8 sikur ti e dije por ju ke thënë atyre që nuk e dije, pra
9 thjesht unë dua ta kuptoj pse ke thënë dy gjëra të ndryshme.
10 Sepse dikush, nuk po them që po e them unë, por dikush mund të
11 thotë se ti ke gënjyer pse nuk e ke thënë se kush ishte personi
12 atëherë në vitin [REDAKTUAR].

13 Nuk e di vetëm thjesht po ju pyes. Nuk është e qartë për
14 mua, s'e kam të qartë unë sepse thua që "e dija pas një muaji
15 se kush ishte personi përgjegjës" dhe pastaj në një ambient
16 zyrtar të pyetet që nuk e dije, pra në vitin [REDAKTUAR] dhe ti
17 ke thënë që nuk e dije se kush ishte personi përgjegjës.

18 Ndoshta ka qenë ajo e vërteta, nuk e di domethënë, e di ti, por
19 thjeshtë po mundohem të sqarohem.

20 Pë. Po, unë s'po them që s'kam thënë "nuk e di". Tash q'ashtu
21 se po shkrin ktu, ama, ndoshta kam harru me të thonë drejtë,
22 pastaj më ka ranë në mend që pas një muaji e kom vërtetu. E qi
23 kjo është e vërteta.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do e
25 rilexoj atë çfarë thatë ju edhe një herë.

1 Pra ti the që ndoshta harrove që t'i tregon të vërtetën
2 UNMIK-ut atëherë, këtë the te përgjigja jote? Në [REDAKTUAR]?
3 Ndoshta ke harru?

4 Pë. Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka
6 pasur ndonjë arsye se pse s'e keni thënë këtë gjë ti, pse s'e
7 ke treguar të vërtetën atëherë?

8 Pë. Po, s'ka pas nevojë ne mos me kallzu të vërtetën, por
9 tashti po t'them apert që kom harrue atëherë, masanej e di se
10 mas një muaji e kom kuptu.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Atëherë të mos ngatërrohemi me atë çfarë po i themi njëri-
13 tjetrit. Nëse të kuptova drejtë, në vitin 1999, pra në bazë të
14 asaj çfarë ke deklaruar ti, pra ti ke mësuar se kush ishte
15 komandanti, kush ishte personi përgjegjës atje ku je mbajt, në
16 vitin 1999. Ndërkohë po flasim për [REDAKTUAR] kur ke dhënë
17 deklaratën. Nuk e kam shumë të qartë atë çfarë the ti. Ti po
18 thua që ke harruar t'ju thuash atyre se kush ishte komandanti,
19 pra në [REDAKTUAR], e ke harruar t'ju thuash atyre se kush
20 ishte komandanti. Këtë po thua?

21 Pë. Po, kom harru me e cek q'ashtu, s'e kom -- nuk e di. S'më
22 kujtohet.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por ty
24 të kanë thënë, të kanë pyetur konkretisht. Specifikisht. Dhe ti
25 je përgjigjur "jo, nuk e mbaj mend" -- "nuk e di" jo "nuk e

1 mbaj mend", po, më fal. Jo "nuk e mbaj mend" por ke thënë "nuk
2 e di".

3 Mbase mos ke pas frikë me e thënë të vërtetën?

4 Pë. Jo, bre, s'kam pas nevojë me pas frikë. Për çka? Unë jam
5 ardh me thanë të vërtetën e jo me rrejt. Se s'kam nevojë, e
6 s'jam marrë edhe -

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
8 kuptoj. Në fakt edhe këtë të kemi thënë, me na thanë të
9 vërtetën, po unë po përpiqem të kuptoj pse tani thua diçka që
10 është ndryshe nga ç'ke thënë në [REDAKTUAR]. Këtë po përpiqem
11 ta kuptoj dhe prandaj edhe disa herë ta bëra pyetjen. Shikoj që
12 nuk po di ç'përgjigje tjetër të japësh përveçse "nuk e di pse e
13 kam thënë q'ashtu".

14 Pë. Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por a
16 kuptoni që në sytë tanë si Trupi Gjykses i Gjykatës, ne duam të
17 kuptojmë pse në një moment ke thënë diçka, e në një moment
18 tjetër thua diçka tjetër?

19 Pë. Ajo mund me ndodh veç njëri kur harron, apo nuk din, apo
20 nuk gabon, apo nuk e di. Veç për q'atë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 kalojmë në pyetje tjetër. A dihej botërisht, publikisht se në
23 Zllash kishte një vend ku i çonin njerëzit aty për me i marrë
24 në pyetje, për t'i mbajtur të ndaluar aty, si të thuash të
25 burgosur. A e dinin njerëzit, në komunitetin -- bashkësia, mes

1 vejta, a e dinin këtë gjë?

2 Pë. Po mrena asaj kohe as kom din unë, as kom mujt me dit

3 kurrkush.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra

5 nuk ishte një nga ato që ne e quajmë sekrete po që i di gjithë

6 bota?

7 Pë. Po nuk e di unë kush e ka ditë. Unë e kom ditë që atë ditë

8 që më kanë marrë e më kanë çu aty, una. Q'aty jam konë. S'kom

9 ditë unë asi gjona që bohen aty. S'kom mujt me kuptu.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Pyetja tjetër që kam, por fillimisht i lutem Sekretares së

12 Gjykatës të nxjerrë në ekran një fotografi me numër ERN 082256.

13 Zonja Sekretare, mos e nxirrni njëherë. Këtë do ta bëjmë

14 pastaj. T'ju jap një numër tjetër. Ndaloni një moment.

15 Është me numrin SPOE00222559.

16 Zoti Dëshmitar, e sheh fotografinë?

17 Pë. Po. [E padëgjueshme].

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e

19 njeh dikë këtu, ndonjë prej këtyre që kanë dalë në fotografi, a

20 e njeh?

21 Pë. Vallahi, po më duket një po e njof. Ma tepër jo.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cilin

23 prej tyre?

24 Pë. Po ai është në anën e djathë temën. Po mendoj, nuk e dikem

25 me siguri.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

2 anën tënde të djathë, prit. A është në gjunjë, a është në

3 këmbë?

4 Pë. Jo, n'gjunj.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është

6 në të majtën tate, apo në të djathtën tate?

7 Pë. [E padëgjueshme].

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

9 fakt, unë ngaqë jemi ulur kështu, e kam të vështirë ta kuptoj.

10 Është ai afër librave, apo ai që është në anën tjetër, larg

11 librave, në gjunjë?

12 Pë. Ky asht personi që po i shkrun aty -- emblema e UÇK.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

14 puna është që të dy e kanë --

15 Personi që është ngjitu aty me librat apo personi që është

16 më larg librave? Apo i sheh librat?

17 Pë. Ai që është në gjuj, dhe personi që ka këtu në gjoks, këtu

18 UÇK të shkrome. A tjerë s'po shoh që po shkrun q'ashtu.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e

20 kuptova. Është ai në gjunjë, ulur afër me librat, pra është në

21 të djathtë. Në rregull.

22 Nuk e di se si mund ta shënojmë, me një laps a diçka, në
23 mënyrë që të jetë më e qartë edhe për proces verbalin e gjyqit.

24 Zoti Prokuror, po shoh se jeni ngritur në këmbë.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kam një sugjerim, mbase është më

1 mirë ta shënojmë me një kolor, a me një laps diçka dëshmitari.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, po
3 dua të di se si mund ta shohim të gjithë. A, duket në ekran, e
4 shohim.

5 [Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës
6 këshillohen]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
8 Dëshmitar, kalo tek ekрани që ke majtas. Në ekranin e majtë,
9 dhe të lutem shëno personin që mendon se po e njeh.
10 Pë. [Shënon]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
12 shohim një rreth të gjelbër rreth këtij personi. Faleminderit,
13 zoti dëshmitar, tani e kemi të qartë.

14 T'jua tregoj edhe një fotografi tjetër, për Sekretaren, ky
15 është me numrin SPO00222547. Më falni, edhe njëherë numri është
16 SPOE00222547.

17 Po këtu, në këtë fotografi, zoti Dëshmitar, a është dikënd
18 që po e njef?

19 Pë. Jo.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
21 një edhe një fotografi të fundit, zonja Sekretare e Gjykatës,
22 mund ta nxjerrësh edhe një herë fotografinë të lutem?

23 Jo, jo, sa ç'ishte e vogël.

24 Pra kjo me numër 547, pyetja -- fotografia e fundit është
25 me numrin ERN082256. Zonja Sekretare, ju lutem mund ta shfaqni

Dëshmitari: W03593 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 15
Marrje në Pyetje nga Trupi Gjykses
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 në ekran këtë fotografi? Mbase mund ta zmadhoni paksa?

2 Zoti Dëshmitar, a e njeh këtë person që është në
3 fotografi?

4 Pë. Jo, nuk muj me e njoft.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Zonja Sekretare, dua tani të kalojmë në seancë private të
8 lutem.

9 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
11 tani jemi në seancë private.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit, zonja Sekretare.

14 Zoti Dëshmitar, dje kemi folur mbasdite edhe pas pak do ta
15 jap edhe numrin e faqes së proces verbalit, diskutuam, folëm
16 dje mbasdite, të pyetëm se se si quhej -- pra kush të tha se si
17 e kishte emrin ai që ta kishte bërë këtë gjë, që të bëri atë që
18 të bëri, domethënë. Dhe, dhe u ngul këmbë -- ngulëm këmbë te
19 kjo pyetje, kush ishin këta person, kush të thanë ty që -- se
20 si quhej ai personi që ta kishte bërë këtë gjë. Ti nuk na e
21 dhe, nuk na i tregove emrat.

22 Dhe unë dua të pyes, mos vallë [REDAKTUAR] të ka thënë që
23 ishte [REDAKTUAR] ai që ta bëri atë që ta ka bërë? Këtë që ka
ndodhur?

24 Pë. Jo.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,

Dëshmitari: W03593 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 16
Marrje në Pyetje nga Trupi Gjykses
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 dua të nxjerrim në ekran këtë dokument me numër 061015-TR-ET,
2 Pjesa 3, e Rishikuar, faqe 24, rreshti 3. Unë nuk e gjej dot
3 menjëherë versionin shqip, nuk e di zonja sekretare, a mund ta
4 nxirrni edhe atë.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të bëj çmos.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit.

8 Për procesverbalin, në transkriptimin e djeshëm është
9 faqja 17, rreshtat 20 -- jo edhe një moment ta shikojmë. Faqja
10 22, rreshtat 8 deri në 11 dhe 18 deri në 20, ku i është bërë
11 pyetja Dëshmitarit lidhur me personin apo personat pra se kush
12 i kishte treguar se kush e kishte rrah, apo kush e mban -- kush
13 jepte urdhra.

14 Duhet që ta gjejmë përpara se ta bëj pyetjen. Shoh që
15 Avokati i Mbrojtjes u ngrit në këmbë? Mirë.

16 Nuk po gjejmë dot përkthimin shqip, po unë po e lexoj siç
17 është në anglisht e kështu Dëshmitari, por edhe i akuzuari mund
18 ta dëgjojë. Faleminderit që po na ndihmoni. E gjetët? Ah, ajo e
19 gjeti, ju ndihmuat.

20 Faleminderit për ndihmën.

21 Zoti Dëshmitar, na u desh pak kohë sa ta gjenim këtë
22 tekstin e duhur. Tani po i kthehem pyetjes. Të pyeta a mos të
23 ka treguar [REDAKTUAR] që [REDAKTUAR] ishte ai që ta ka bërë
këtë gjë,

24 dhe ti the "jo, nuk m'ka tregu [REDAKTUAR] ". Tani unë dua të
25 lexoj faqen 24 -- kjo është faqja 22, zonja Sekretare. Është

1 faqja 24 por për përkthimin shqip është faqja 28.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është faqja 28 në shqip.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Zoti Dëshmitar, në këtë intervistë që të kanë bërë,
6 pyetje-përgjigje, është pjesa ku diskutohet se kush është
7 përgjegjës për këtë që të kanë bërë ty, edhe aty të pyesin edhe
8 për këtë [REDAKTUAR], po diskutohet për [REDAKTUAR], deh të
9 kanë pyetur "po të ka kallzu, a të ka tregu se sipas atij kush
10 ishte përgjegjës për këtë" dhe ti ke thënë "Po, sigurisht. E
11 jua kam thënë një herë, ju lutem boll po më lodhni. Sigurisht
12 që ai e dinte. Ju thashë, ishte [REDAKTUAR] dhe pikë". Pastaj
13 të pyesim prapë "po a është kjo çfarë të ka thënë [REDAKTUAR]"
14 dhe ti thua "po ti a po merr vesh, më ka thënë [REDAKTUAR], 500
15 herë dhe kjo është e vërteta. Dhe sigurisht ju e dini të
16 vërtetën më mirë se unë"

17 Tani po të pyes, kjo që ke thënë atëherë a është e
18 vërtetë?

19 Pë. Po ai, kam harru apet -- po masi kom thonë që q'athu,
20 normal që është e vërtetë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
22 deklaratë nuk është e para shumë kohëve, nëse flasim kështu në
23 krahasim. A mos ke frikë që ishte ky i quajtur [REDAKTUAR] ai
24 që të ka treguar? Jemi në seancë private tani, nuk na dëgjon
25 kush jashtë sallës.

1 Pë. Zonja Gjykatëse, po më vjen shumë shumë interesante
2 krejt juve. Qysh moj unë mos me ditë kush o kanë komandant në
3 Zllash, kurse ku jetoj, krejt njerëzit e kanë ditur që unë jom
4 konë i torturuam aty, e tash qysh po them ju, me ja u tregu une
5 krejt emrat me kë kom fol, me 500 vetë, krejt me jua tregu, ma
6 merr mendia nuk është nevoja, ma merr mendia, nuk është nevoja,
7 dhe nuk po kom qejf as me një emër kurrkund me cek se në këtë
8 gjykatën nuk kom ardh për kurrkënd po jam ardh për veti me
9 dhanë deklaratën. E mos më merrni në pyetje kush a konë q'aji,
10 kush o konë -- se unë nuk jam hetues as jam gjykatës, as jam
11 njeri i marrun - veç personal për veti. Po askand, hiç.

12 Dhe normal, normal, pajtohem që deklarata që kom dhënë që
13 atëherë, se unë edhe harroj, po të them, jam bo operacion mbas
14 6 muajve, krejt harroj çka kam thonë. Nuk duhet me e marr si --
15 ma merr mendja që, as jam ardh me rrejt, as jam ardh për
16 kurrgjë, as jam ardh, po foli kështu publikisht, të akuzuarin
17 me e dënu. Për mu s'e lëshon ai. Po shkon për shpie. Nuk jom
18 ardh për atë punë hiç, se nuk kam nevojë, se nuk jam ardh --
19 nuk jam ardh me u hakmarrë, por jam ardhur dhe ma së shumti jam
20 ardhur shkaku i zonjës, jam ardh, se s'kisha ardh hiç. Po ju
21 kallzoj drejt.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
23 Dëshmitar, ne të falënderojmë shumë që je ardhur këtu dhe të
24 falënderojmë shumë që këto ditë ke qenë me ne këtu, për me
25 dëshmu në sallë të Gjykatës.

1 Ama, është e rëndësishme që gjykatësit me t'i bo disa
2 pyetje, që ne mendojmë se ne janë të rëndësishme për ne që të
3 arrijmë në një vendim dhe ne në të ardhme, ta marrim dhe ne një
4 vendim. Unë e kuptoj, po përpiqem të kuptoj, se çfarë ke thënë
5 në një moment dhe nëse thua që kam harruar, e pranoj si
6 përgjigje ama ne -- ti duhet të na kuptosh që ne na duhet t'i
7 këqyrim këto gjëra, edhe nëse thua nuk e di, në rregull, e
8 pranoj.

9 Por ne duhet e kemi për detyrë të t'i bëjmë këto pyetje
10 dhe mirë bëjmë që t'i bëjmë këto pyetje se nuk e bëjmë ne dot
11 punën, detyrën tonë po s'i bëmë dot këto pyetje me sqaru
12 gjërat.

13 Unë këtu nuk po them se ti gënjen, unë dua të sqaroj
14 gjërat, se thjesht nuk e ndarë mendjen. Dua të kuptoj se si
15 janë gjërat. Mirë, do bëj edhe disa pyetje të tjera që duhet
16 t'i bëjmë po në seancë private sepse mundet që të
17 identifikoheni -- mund të identifikosh se kush je, prandaj do
18 të qëndrojmë kështu siç jemi, në seancë private.

19 U cek paksa edhe gjatë dëshmisë, por pyetja është kjo: a e
20 di ti pse të morën ty? Pse të burgosën aty?
21 Pë. Nuk muj me dit pse m'kanë marrë. Nuk muj me ditë pse
22 m'kanë marrë. E dinë ata, unë s'maj [e pakuptueshme].

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 deklaratën e UNMIK-ut që e cekëm pak më parë, por po ja them
25 Sekretares, është më konkretisht me SPOE00127752, faqja 2, ti

1 ke thënë aty se të kanë thënë ata që "kam me ta thy gishtin se
2 ke bashkëpunu me serbët".

3 Pse e kanë thënë këtë?

4 Pë. E vërtetë, q'ashtu më kanë --

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Domethënë ata ta thanë -- ata të thanë që ata kujtonin se ti
7 ishte bashkëpunëtor, bashkëpunojë me serbët.

8 Pë. Kanë mendu se unë kam bashkëpunu me serbët dhe jam ni far
9 lloj spiuni aty. S'jom n'jetë teme spiun, as e di çka me kone
10 spiun. Edhe kam kqyr punët e mia, nuk kam bo kurrëgjë, por q'ata
11 m'kanë akuzu, qi jom konë gjoja si kom punue me serbët.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e
13 ke ndonjë -- a të shkon mendja pse, pse e kanë mendua ata atë
14 gjë?

15 Pë. Menia nuk m'sh -- nuk e di pse, edhe nuk di në jetë teme
16 që ktij person që kam pas diçka borxh, apo ndonji familjari
17 t'tina, i kom pas borxh, apo ka mendu me u hakmarr në q'at
18 moment. Unë nuk muj me kuptu kta, nuk e di. Borxh s'i kam pas
19 kurrkujt, n'jetë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Atëherë dua të bëj ca pyetje [REDAKTUAR]. Ditën që je larguar
22 nga Zllashi ku të kishin mbajtur, në ç'gjendje [REDAKTUAR]?

23 Pë. S'e kuptova pyetjen.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ditën
25 e ofensivës, që ju thanë ikni, ose të thanë ty "ik tani, shko",

1 Lata si ishte? Në ç'gjendje e le [REDAKTUAR]?

2 Pë. Po unë [REDAKTUAR] -- në gjendje normale. S'di çka me
3 t'thanë. Tybe me t'thanë t'drejtën se kom kqyr fort se e kom ka
4 rrok tuta jeme, a po m'lshojn edhe mu a s'po m'lshojn. Se veç
5 s'e di ça o met q'aty, mas meje o met. Unë jam tre jena met,
6 unë dola, dy janë met aty. As kom kthy ktryt me kqyr ma se
7 ç'asht, unë kom kqyr problemin tem, me ik sa ma shpejt, s'e di.
8 N'gjenie t'mirë a konë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
10 rrinte dot në këmbë?

11 Pë. Po, ka nejt shumë, edhe ka nejt. Ka mujt me nejt.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
13 mujte me ec ai?

14 Pë. Por s'ke pas ku me ecë, se s'kena guxu as me ecë. Aty në
15 q'atë ven që jena konë s'e di, këna nejt, s'kena guxu as me
16 ecë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
18 fal, zoti Dëshmitar, nuk isha unë e qartë. Po. Fizikisht a
19 ishte ai në gjendje me ec, nga që ishte maltrajtu, flas. A mund
20 të ecte, po të kishte mundësi me ecë, pra a mund -- a fizikisht
21 a ecte dot?

22 Pë. Mëndia ma merr që ka mujt me ecë, menia ma merr.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur
24 ike ti, [REDAKTUAR]?

25 Pë. Po, tanë kohës i [REDAKTUAR].

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 deklaratën që ke dhënë ti në intervistën e ZPS-së me numër
3 06105-TR-ET, Pjesa 4, e Rishikuar, RED3, faqe 10, rreshti 4, ti
4 ke thënë: "[REDAKTUAR]". Si e dije ti që Latën e kanë vra?
5 Pë. Po unë normale e kom ditë që [REDAKTUAR] nuk ekziston, unë
nuk e

6 dija kush e ka vra, po ai nuk asht. Kush ka vra, nuk e di unë
7 se nuk e kam përcjellë Latën kush e ka vra, e kush s'e ka vra.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por,
9 ndoshta nuk mund të ketë ndodhë që ai të ketë pas vdekur për
10 shkak të plagëve të kishte?

11 Pë. Mundet edhe ashtu, nuk e di unë, unë s'po -- çka ka ndodh
12 me atë nuk di unë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
14 pra, për këtë ta bëra pyetjen, se ti the që Latën e kanë e vra
15 dhe unë të pyeta, ku e di ti që [REDAKTUAR] e kanë vra?

16 Pë. Kam paramendu që ashtu, se ai nuk ekziston mo. E nuk e di.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit, zoti Dëshmitar.

19 Tani po shoh në të djathtën time dhe do t'i jap fjalën
20 kolegëve, që të bëjnë edhe ata disa pyetje.

21 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Faleminderit, zonja
22 Kryegjykatëse.

23 Zoti Dëshmitar, unë jam prej Gjykatësve të Trupit Gjykses,
24 unë quhem Ronald Dekkers. Të falënderoj për durimin dhe dua që
25 t'ju bëj disa pyetje të tjera, në mënyrë që të qartësohemi pak

1 më shumë. Së pari, dua t'ju lexoj një paragraf, një pjesë të
2 vogël nga intervista që i keni dhënë ZPS-së, me [REDAKTUAR]
3 [REDAKTUAR], që është dokumenti me numër 0061015-TR-ET, Pjesa 3
4 E rishikuar, faqja 17, rreshti 10 dhe më poshtë.

5 Kryetarja e Trupit Gjykses më kujton që të vazhdojmë akoma
6 në seancë private apo në qoftë se do të dalim në seancë
7 publike. Përgjigjja është që nuk është e nevojshme që ne të
8 jemi në seancë private tani, kështu që do t'i kërkoja
9 sekretares që të kalojmë në seancë publike.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shikoj
11 që avokati të akuzuarit është në këmbë.

12 Fjala për juve.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Përpara se sa të kalojmë. Në
14 seancë publike, dua që të sqarojmë diçka dhe do të doja t'i
15 kërkonim Dëshmitarit që të heqë dëgjueset.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
17 Dëshmitar, a i heq dot dëgjueset të lutem?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar.

19 Çështja është që kur tregojmë fotografi të caktuara, pra
20 pa diskutim që ato transmetohen, seancat transmetohen në Kosovë
21 dhe gjithandej tjetër në botë. Domethënë është një kanal online
22 që bën transmetimin e çdo gjëje që ndodh këtu, kështu që nuk do
23 të donim që për të ardhmen të shikohen fotografi të tilla sepse
24 kjo mund të sugjestionojë dëshmitarë të tjerë në momentin kur
25 ata të vijjnë këtu, pra dhe të bëjnë dëshminë e tyre në sallën e

Dëshmitari: W03593 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në Pyetje nga Trupi Gjykses
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 24

1 gjyqit. Kështu që thjeshtë do të doja të tërhiqja vëmendjen
2 tuaj për këtë gjë. Mendoj që do të ishte mirë, do ishte e
3 zgjuar që të mos e transmetonin dhe të mos e shikonte publiku i
4 gjerë këto fotografi.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit, zoti avokat.

7 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
8 këshillohen]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
10 nderuar Avokat i Mbrojtjes, asgjë nuk është transmetuar dhe
11 asnjë fotografi nuk është e aksesueshme, apo e qasshme për
12 publikun.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit Sekretare që informuat dëshmitarin që të vendosë
16 dëgjueset.

17 Atëherë, zoti Dëshmitar, do i jap edhe një herë fjalën
18 kolegut tim, gjykatësit në të djathtën time.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
20 Sekretare, a mund të kalojmë në seancë publike.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Tani jemi në seancë
22 publike.

23 [Seancë e hapur]

24 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Do ta përsëris edhe një herë
25 zoti Dëshmitar. Dua që t'ju lexoj një pjesë nga intervista që i

1 keni dhënë ZPS-së me datë [REDAKTUAR]. Është dokumenti me
2 numër 061015-TR-ET, Pjesa 3, E rishikuar, faqja 17, nga rreshti
3 10 dhe më poshtë.

4 Ty të ka thënë intervistuesi si më poshtë:

5 "Zoti dëshmitar, [REDAKTUAR] ti the që e ke parë dy
6 herë në Zllash. Të dyja herët që të kanë rreh ke parë komandant
7 Calin. A je patë?" dhe ti je përgjigjur "Po, ai më ka rrah mu".
8 Po. Dhe pastaj vijon më tej:
9 "Kur ke qenë në Zllash ti, a e ke parë këtë person ndonjë herë
10 tjetër përveç këtyre dy herëve që je rreh?"

11 Dhe ti je përgjigjur:

12 "Unë mendoj se e kam parë edhe një herë tjetër kur është
13 futur te hauri ku kemi qenë, me disa ushtarë të tjerë, erdhi
14 dhe doli prapë".

15 A e mbani mend që ja ke thënë këtë ZPS-së?

16 Pë. Po. [E padëgjueshme].

17 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] A i ke thënë të vërtetën
18 ZPS-së ti atëherë?

19 Pë. Ma merr menia që po.

20 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] A mund të ketë ndodh që ti
21 ta kesh parë [REDAKTUAR] edhe në raste të tjera?

22 Pë. Jo, kurrë n'jetë s'e kom pa.

23 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Atëherë dua që t'ju lexoj
24 një paragraf nga deklarata që ti ke dhënë në [REDAKTUAR]
25 përpara Gjykatës këtu, me [REDAKTUAR]. Dua të të lexoj
transkriptimin në

1 faqen 65, nga rreshti 19 e më poshtë.

2 Ty të është bërë pyetja dhe përgjigja që ke dhënë ti është
3 kjo:

4 "Kur u futa në makinë", dhe e ke fjalën këtu për kerrin që
5 të mori dhe që ishte në mes të rrugës, nga vendi në Zllash ti
6 the që "kur u futa n'kerr, ai më gjujti boks tek dhëmbët. Unë
7 fillova që të më rridhte gjak dhe përnjëherë më vendosën një
8 thes në kokë".

9 Pyetja është kjo:

10 "Kush e bëri këtë gjë?"

11 Dhe ti thua pastaj:

12 "Këtë gjë ma boni personi i cili kishte kapele të kuqe".

13 Pastaj të bëhet pyetja:

14 "A nuk ishte ky personi që e ngiste makinën?". Përgjigja
15 nga ti ishte:

16 "Jo, nuk ishte personi që ngiste makinën. Personi që
17 kishte kapelën e kuqe ishte ulur mbrapa makinës bashkë me mu".

18 Pyetja që kam për ty, zoti Dëshmitar është kjo:

19 A i referoheni personit që kishte kapele të kuqe në kerr,
20 a është ky person i njëjti person që ka pasur kapelën të kuqe,
21 që të ka rreh ty kur ke qenë në burgim, është i njëjti person
22 ky me kapele të kuqe?

23 Pë. Vallahi që ashtu po ma përzhini, s'po muj me ju kuptu as
24 juve. Unë ju kam thonë, se kom njoft se kush është komandant,
25 as kush nuk o komandant. Mu kur m'kan marr, m'kan fut në kerr,

1 qja person -- veç muj me thonë e ka pas kapelën e kuqe. Q'ai
2 m'ka ra n'gojë edhe ma ka shti thesin në gojë. Po s'e kom dit
3 kush asht komandant aty, as e kom njoft, as e kom ditë.

4 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Po ky personi me kapele të
5 kuqe që i drejtohesh ti, te deklarata që bëre përpara gjykatës,
6 dhe me sa kam lexuar unë procesverbalin, kjo ishte pjesa e parë
7 ku ti e ke përmendur për herëte parë personin që kishte kapele
8 të kuqe, në xhip, në kerr. Po këtij personi ti nuk i drejtohesh
9 si komandant Cali, nuk i referohesh si [REDAKTUAR]. Kjo
10 është pyetja.

11 Pë. [E padëgjueshme] me kapele të kuqe më ka rreh dy herë, dy
12 herë. Unë as e kom njoftë, as e njof. Me pas e njof, a beson se
13 nuk e njof. S'e kom pa n'jetë, e kom pa por, s'e di ça kom pa
14 aty, unë nuk e di kush o konë. Por e dija masanej se o konë
15 komandant, se o konë qi ky i akuzumi. Q'aty në q'at vend
16 atëherë ai o konë, tjetër kush s'ka mujt me konë.

17 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Dhe a ka të bëjë kjo edhe me
18 personin me kapele të kuqe, domethënë a ishte i njëjti person
19 ky personi me kapele të kuqe që të boksoi kur ishe në kerr?

20 Pë. Po.

21 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] E vë re që këtë nuk e ke
22 përmend më përpara. A e kishe harru, lidhur me atë ça të kishte
23 ndodhur ty në kerr?

24 Pë. Ka mujt që kam harru.

25 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Faleminderit shumë. Kam një

1 pyetje tjetër të fundit.

2 Ke thënë, ke deklaruar më përpara dhe e kam bërë një
3 përmbledhje të deklaratave të mëparshme që i ke dhënë ZPS-së
4 dhe deklarimeve që ke bërë këtu përpara Trupit Gjykses që ty të
5 kanë bërë llom, të kanë rrahur keq në Zllash dhe në vende të
6 tjera dhe si rezultat i kësaj, ti je dëmtuar. Par ke thënë po
7 ashtu që edhe [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] dhe po ashtu
8 [REDAKTUAR]. Po ashtu ke deklaruar
9 që ke pësuar [REDAKTUAR] të rënda [REDAKTUAR], edhe të është
10 dashur me u operu për këtë arsye. Sa i takon [REDAKTUAR], ke
11 thënë që ke shku [REDAKTUAR].

12 Të lutem, a më thua dot se çfarë ndodhi [REDAKTUAR] që të
13 [REDAKTUAR] siç e the ti? Çfarë ndodhi në rastin
14 e [REDAKTUAR]? A shkove te doktori edhe për [REDAKTUAR] apo jo?
15 Pë. Po, pastaj jam shku, ama në q'atë moment s'kom pas ku me
16 shku te doktori se jam konë i burgos. Kur jom liru, atëherë jom
17 shku te doktori, por a konë pak vonë.

18 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Dhe doktori ta [REDAKTUAR]

19 Pë. Po.

20 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] E njëjta ndodhi edhe për
21 [REDAKTUAR]?

22 Pë. Po.

23 GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Po t'i bëj këto pyetje dhe
24 po shikoj ZPS-në sepse nuk kam parë asnjë dokument mjekësor që
25 lidhet me [REDAKTUAR]. Ndoshta e kam gabim unë, por

1 nuk kam parë ndonjë dokument që lidhet me këto të dyja.

2 Faleminderit shumë, zoti Dëshmitar. Kaq pyetje kisha për
3 ty.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit. Tani shoh në të majtën time, kolegu tjetër. Më
6 lejoni t'i jap fjalën tani kolegut në të majtën time.

7 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] I nderuar Dëshmitar,
8 faleminderit për durimin, unë jam Gilbert Bitti. Mos u
9 shqetësoni se jemi shumë afër fundit të dëshmisë tuaj, vetëm
10 pak pyetje kam.

11 Në dëshminë që keni dhënë këtu të hënën para nesh, ju
12 përshkruat që ty të kanë rrahur dy herë dhe the që të dyja
13 herët të ka rrahur një burrë që kishte kapele të kuqe. Vë re që
14 ky person të ka thënë ca gjëra kur të ka rreh.

15 Për shembull, në rastin e parë kur të ka rreh, të ka
16 thënë, sipas asaj që the ti, domethënë të vendosi revolverin në
17 ballë, dhe ti the që "lere, le të shkojë, se qeka me fat ky
18 personi". Pastaj herën e dytë, kur të ka rrahur prapë, të ka
19 thënë gjana, ky personi që të ka rreh. Për shembull, të ky pyt,
20 "kush janë hajnat"?

21 Kam një pyetje për ty, ti a e njohe zërin e personit gjatë
22 herës së dytë që të kanë rreh. A kishte të njëjtin zë personi,
23 sipas teje, domethënë, ishte i njëjti zë që të fliste?

24 Pë. Tybe, nuk jom nal me studjue zanat, po unë veç po tregoj
25 me q'atë personin që kom pas dy herë punë. Me kapele të kuqe.

1 Edhe herën e parë, edhe herën e dytë, zanat e tyne ja kom vue
2 se s'jam -- s'muj me i vu zanat --. S'e di.

3 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit. Sipas teje, ditën
4 kur je liruar, na e the edhe këtu përpara gjykatës që ju ishit
5 17 te ky hauri, ku jeni mbajt në Zllash, dhe na the që ti ke
6 qenë nga të fundit që të kanë liruar. A është e saktë kjo?
7 Pë. Po.

8 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Po ashtu ti na the, dhe ka të
9 bëjë me herën e parë që na the, domethënë që ata të thërritën
10 me emër. A e njihje ti ndonjë prej atyre emrave që u thërritën,
11 ndonjë prej këtyre emrave ose të gjithë emrat, i njihje?
12 Pë. Nuk e kuptova pyetjen.

13 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Atë ditën kur të liruan nga
14 Zllashi, ushtarët ju thërritën me emër the ti, të thërritën ty,
15 thërritën edhe të tjerët dhe hera e parë që ti thau që ju
16 thërritën me emër. Pyetja ime është kjo: e i dëgjove emrat e
17 personave të tjerë, a i njoftë emrat e personave të tjerë, ose
18 të ndonjë personi tjetër?

19 Pë. Po se tjetër punë s'kom pas unë me ngju emrat e huj, ça po
20 folin, kush, une veçëm e kom ni më kanë hurr mu n'emër dhe jam
21 dalë jashtë. Kurrgjë tjetër.

22 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Mirë, në rregull. Ata që të
23 thirrën në emër ty, ata po të flisnin shqip edhe ty edhe të
24 tjerëve?

25 Pë. Normal që po.

1 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] A mendo ti që të gjithë
2 personat që ishin të ndalum aty me ty vinin nga i njëjti rajon
3 në Kosovë, apo jo?

4 Pë. Nuk muj me e ditë.

5 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Kam edhe dy tre pyetje të tjera
6 që kanë të bëjnë me numrin e personave që ishin të mbajtur, të
7 ndaluar aty me ty. Dua t'ju pyes në qoftë se të gjithë këta
8 njerëz kanë qëndruar me ty në të njëjtin vend gjatë të gjithë
9 kohë apo disa prej tyre kanë qëndru të ndalum vetëm për një
10 periudhë më të shkurtër, jo njësoj me ty?

11 Pë. Jo ata njerëz që janë konë, kanë qëndru aty. Po herë pas
12 here kan pru tjerë njerëz, tybe s'e kam ni se i kan pru.

13 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Familja jote a kishte dijeni se
14 ku ishe i ndalum, i burgosur?

15 Pë. Po.

16 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] A dihej në rajon që ushtarët e
17 UÇK-së kishin një vend në Zllash ku ndalonin ose burgosnin
18 njerëz? Përderisa e dinte familja jote, unë du me t'pyt ty, po
19 të tjerët a dinin që kishte një vend ndalimi, burgosjeje në
20 Zllash?

21 Pë. O zotëri, ata s'e kanë dit që ka burg se s'kanë mendu që
22 asht kohë e burgut, po ata kanë mendu se më kanë marrë diçka me
23 m'pyt. As unë s'kam besu që mund me kon me pas asi trajtimi në
24 Zllash. S'kam besu.

25 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Pra, ditën që erdhën dhe të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në Pyetje nga Trupi Gjykses
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 32

1 morën dhe të thanë që do shkojmë në Zllash, ti nuk e dije se ku
2 po të çonin, nuk e dije saktësisht se ku do të çonin, apo e
3 kishe një ide deri diku?

4 Pë. Po s'e kom dit se janë ardh dy ushtarë, mu kanë prezantue,
5 thanë "na jem policë ushtarakë, edhe me ardh me ne, dhe deri në
6 Zllash, veç kemi me t'pyt diçka". Edhe une s'kom dasht me
7 kundërshtu e jom shku, unë e kom menduar ne bisede me mu po
8 bojn, e s'kom besu se po m'bojn llom. Se s'i kam pas borxh
9 kurrkujna, hak kurrkujt, nuk e di.

10 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Kemi një ose dy pyetje të tjera
11 por dua që të kalojmë te seanca private se mund të
12 identifikojmë dikë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit.

15 Zonja Sekretare, nuk e në qoftë se mund të kalojmë në
16 seancë private, dhe për proces verbal, më informuam që kemi
17 edhe pesëmbëdhjetë minuta shtesë pas orës 1 në mënyrë që të und
18 të vijojmë me pyetjet.

19 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] E nderuar, jemi në
21 seancë private.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit, Kryegjykatëse.

25 Zoti dëshmitar, ti na the dje që kur u lirove, rrugës për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në Pyetje nga Trupi Gjykses
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 33

1 në Prishtinë ti shkove te [REDAKTUAR] dhe kjo
2 jepet në faqen 104, rreshti 20 të transkriptimit të datës së 20
3 shtator. Dhe ti na the ne që [REDAKTUAR] se ku është
4 [REDAKTUAR]. Na the po ashtu që [REDAKTUAR] e dinte që ne
5 qëndronim, po që kishin qëndru aty në haur, në të njëjtin dhomë
6 dhe ti thua më pas që [REDAKTUAR]. Dhe ai [REDAKTUAR]
7 [REDAKTUAR]:
8 [REDAKTUAR].
9 Sipas jush, nga e dinte [REDAKTUAR] që [REDAKTUAR] nuk do
10 lirohej?
11 Pë. Po ai veç -- nuk muj me dite unë qysh. Por veç [REDAKTUAR]
12 [REDAKTUAR], unë nuk muj me e kuptu
13 atë punë, qysh - tek, se absolut s'kena bo asnjë llaf. Po s'i
14 thamë, [REDAKTUAR]
15 [REDAKTUAR]. Ai veç i
16 fjalë ka fol, ka thonë: "Nuk po ma merr mendia" dhe kaq.
17 Kurrgjë s'kena pas fol ma atë, [REDAKTUAR],
18 unë e di pse e qysh.
19 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Pastaj the: [REDAKTUAR]
20 [REDAKTUAR]
21 Po pse? A edhe ti vetë e dije se s'kishte me u kthy
[REDAKTUAR]?
22 Pë. Jo, zotëri, se unë nuk jam konë gjykatës aty e as jam konë
23 polic, e as jom konë kurrgja. Une e di që metsha aty edhe o
24 dalë, unë jam dale dhe ai meti. Ma s'kom dit unë kurrgjë për
25 atë. Aty janë njerëzit që e dinin për të, se une s'e di, se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në Pyetje nga Trupi Gjykses
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 34

1 s'muj me e ditë. As kom mujt me e ditë.

2 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] E nuk i njeh ti ata njerëz?

3 Pë. Po normal s'i njoh.

4 GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit shumë zoti

5 Dëshmitar.

6 Zonja Kryetare e Trupit Gjykses, unë i mbarova pyetjet e
7 mia.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
9 Dëshmitar, kemi mbërritur kështu në fund të dëshmisë tënde. Siç
10 e thashë më përpara, katër ditë po bëhen që je me ne, e kemi
11 parë që ka qenë e lodhshme për ty, e vështirë. Dua të të
12 falënderoj sepse unë besoj që dëshmia jote do të na ndihmojë në
13 përpjekjen tonë për të gjetur të vërtetën. Të falënderojmë
14 shumë.

15 I lutem Sekretares të na kalojë në seancë publike, se dua
16 që këto fjalë t'i them në seancë publike. Zonja sekretare të
17 lutem.

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 jemi rikthyer në seancë publike.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
22 sekretare ju thatë diçka, nuk ju dëgjova mirë. Jemi rikthyer në
23 seancë publike?

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi rikthyer në seancë

1 publike.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit. Zoti Dëshmitar, do ta përsëris edhe një herë atë
4 çka thashë pak më parë. Kemi mbërritur kështu në fund të
5 dëshmisë tënde. Katër ditë po bëhen që je këtu me ne, ma merr
6 mendja ka qenë e lodhshme, e vështirë për ty dhe të falënderoj
7 që ke qenë këtu këto ditë me ne, na ke ndihmuar shumë në
8 përpjekjen tonë me zbulu se çfarë ka ndodh atëherë, me zbulu të
9 vërtetën. Tani të uroj udhëtim të mbarë, të kujtoj edhe një
10 herë të mos flasësh me askënd për deklaratën që e ke dhënë këtu
11 para gjykatës speciale të Kosovës Kemi kryer bashkë.

12 Faleminderit.

13 Zonja shoqëruese, a mund ta shoqëroni dëshmitarin për të
14 dalë nga salla e gjyqit ju lutem.

15 [Dëshmitari largohet nga salla]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Palët
17 dhe mbrojtësja e viktimave, kanë diçka për të ngritur?

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nga ana e
19 Prokurorisë nuk ka asnjë parashtrim.

20 ZNJ. PUES: [Përkthim] Nuk ka asgjë.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Asgjë nga ne.

22 RYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë
23 do të ndalojmë këtu dhe do të rifillojmë në orën 14.30, me
24 dëshmitarin tjetër të prokurorisë.

25 Seanca mbyllet këtu.

1 --- Seanca mbyllet në orën 13.03

2 --- Seanca rifillon në orën 14.30

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni
4 ju lutem. Mirë se erdhët. Shikoj nëse ka ndonjë ndryshim në
5 përbërjen e ekipeve. Shikoj në anën e djathë nga Zyra e
6 Prokurorit të Specializuar.

7 MR. DE MINICIS: Mirëdita të nderuar Gjykatës. Prokuroria
8 ka shtuar në ekip znj. Deborah Osbor, stazhiere ligjore.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit. Shikoj nga Mbrojtësja e Viktimave, është po e
11 njëjta përbërje. Po kështu edhe ekipi i mbrojtjes ka të njëjtën
12 përbërje. Shoh edhe zyra administrative gjithashtu. Vërej edhe,
13 të shoh njëherë, a po ja ku jeni, vë re praninë e Z. Hans van
14 de Wal i cili është caktuar si avokat në detyrë për dëshmitarin
15 W4600 i cili do të dëshmojë këtë pasdite. Për procesverbalin
16 kjo është në bazë të dokumentit me numër F194.

17 Ju lutem shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë.

18 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Dëshmitar, mirëdita.

21 DËSHMITARI: Mirëdita.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
23 se ke ardh në Dhomat e Specializuara. A më dëgjon?

24 DËSHMITARI: Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] T'ia

1 nis nga e para. Si je?

2 DËSHMITARI: Faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit z. Dëshmitar.

5 Sot do ta fillojmë me dëshminë tënde. Por përpara kësaj,
6 përpara dëshmisë, dua të them disa gjëra.

7 Fillimisht, du me shpjegu qartë me fjalë të qarta, më fal
8 një moment. Pra fillimisht të shpjegojmë me masa të qarta masat
9 mbrojtëse, me fjalë të qarta masat mbrojtëse që janë miratuar
10 për dëshminë tënde. Të është caktuar një pseudonim, që do të
11 thotë që emrin nuk do ta përmendim asnjëherë por gjithmonë do
12 të të quajmë kur të drejtohem me fjalët z. Dëshmitar, në
13 mënyrë që askush të mos ta di se kush je.

14 Gjithashtu dëshmia jote do të jepet me shtrembërim të
15 zërit dhe të fytyrës, që do të thotë se askush jashtë kësaj
16 salle të gjyqit që e shikon transmetimin, nuk mund të ta shohë
17 fytyrën e nuk mund të ta dëgjojë zërin e vërtetë, gjatë
18 dëshmisë tënde.

19 Nëse do të bëhen pyetje që nuk ta zbulojnë identitetin,
20 këtë do ta bëjmë në seancë të hapur, do të thotë që publiku
21 mund ta dëgjojë atë që thuhet në sallë të gjyqit.

